



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2022:002302

Datë: 12.01.2024

Numri i dokumentit: 05182405

C.nr.31/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Nazmi Neziri, dhe procesmbajtësen Afërdita Ejupi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. Sh. nr. Personal, nga fshati P., Komuna e Podujevës, të cilin e përfaqëson i autorizuari S. B., avokat nga Prishtina, Rruga “R. L.”, Hyrja ., Kati –-të, nr....., me autorizim, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria e Arsimit nga Podujeva, Rruga “N. G.” pn., me objekt kontesti: Kompensimin e ushqimit-shujtave ditore dhe 70% e shpenzimeve të udhëtimit, me vlerë të kontestit: 1,751.80 Euro, jashtë seance me dt.12.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- pa shqyrtim kryesor të çështjes -

APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit B. Sh. nga fshati P., Komuna e Podujevës, **si e bazuar**, dhe:

DETYROHET e paditura Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B. Sh. nga fshati P., Komuna e Podujevës, t’ia kompensojë në emër të Ushqimit ditor për ditët e pranisë në punë për 32 ditë pune, (për periudhën 18.04.2017 deri me datë 05.05.2022), nga 2 euro në ditë, shumën prej 64.00 euro, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të rrugës-udhëtimit për 70%, për 106 ditë të pranisë në punë, (për periudhën 18.04.2017 deri me datë 05.05.2022), shumën prej 178.08 Euro, e të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 242.08 Euro, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar ti llogaritet nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 Euro, të gjitha në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit.

REFUZOHET kërkesa e paditësit përtej shumës së aprovuar në vlerë prej 1,509.72 Euro, **si e pa bazuar**.

DETYROHET paditësi B. Sh. nga fshati P., Komuna e Podujevës, që në emër të taksës gjyqësore shtesë për padi të paguajë shumën prej 10.00 €, në llogarinë e gjykatës, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi, nëpërmes të autorizuarit të tij, me datën 10.01.2022 në këtë gjykatë, ka paraqitur padi kundër të paditurës për Kompensimin-pagesën e ushqimit-shujtave ditore dhe 70% të shpenzimeve të udhëtimit për ditët e pranisë në punë, ashtu që ka kërkuar shumën si në petitumin e padisë.

Ka shtuar se paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune të e paditura në vendin e punës mësimdhënës. Ka theksuar se duke marrë parasysh nënshkrimin e Kontrata kolektive të Arsimit të Kosovës, të datës 18.04.2017, dhe kontratës individuale, deri me tani nuk ka bërë kompensimin në emër të kërkesave të paditësit përkundër se kontrata ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit, në shumën si në petitumin e padisë.

Andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurën që të bëjë kompensimin e shumës së precizuar në emër të kërkesave të lartcekura.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare duke theksuar se e konteston kërkesëpadinë si dhe precizimin e paditësit, për pagesën e shpenzimeve të transportit. Ka shtuar se paditësi fillimisht është dashur që këtë çështje ta inicioi në procedurë administrative, duke ju drejtuar të paditurës. Ka theksuar se padia nuk ka bazë juridike, ngase me dispozitat kalimtare të kontratës kolektive në fuqi nga dt.18.04.2017, në nenin 46 të saj është paraparë se MASHT dhe SBASHK, angazhohen bashkërisht për t'i informuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5,7 dhe 8 e këtij neni andaj e paditura nuk ka buxhet për kryerjen e obligimeve ndaj punëtorëve.

Më tej ka shtuar se paditësi fillimisht është dashur të iniciojnë këtë çështje në procedurë administrative me kërkesë tek e paditura dhe nga shkresat e lëndës shihet se paditësit nuk kanë shtjerrë mjete e brendshme juridike.

Ka theksuar se paditësi kompensimin e shujtave për 444 ditë pune, e ka realizuar me aktgjykimin C.nr.114/20, kurse sa i përket shpenzimeve të udhëtimit konsiderojmë se kemi të bëjmë me parashkrim të pjesërishtëm të kërkesës së paditësit konform nenit 87 të ligjit të punës, ngase kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit e kërkon nga data 18.04.2017 ndërsa padinë e ka ushtruar me dt.10.01.2022, apo 370 dite pune për shkak të parashkrimit.

Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka

gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se i padituri i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura për shumë vite përvojë pune, po ashtu nuk është kontestuese se e paditura nuk iu ka paguar pjesërisht paditësit kompensimin për ushqim të shujtave ditore dhe 70% të shpenzimeve të biletës, për ditët e pranisë në punë për periudhën e kërkuar, pasi që një gjë e tillë nuk kontestohet nga palët, kjo vërtetohet dhe me provat materiale në shkresat e lëndës.

Andaj, gjykata, konform nenit 152 dhe 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht me nenin 35 par.5 është paraparë se: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban.”*, ndërsa në par.7 të njëjtit nen është paraparë se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim.”*, por këtë nuk e ka bërë e paditura edhe pse ka qenë e obliguar ta bëjë këtë.

Po ashtu kjo është e rregulluar me Ligjin nr.03/L-212 e Punës, sipas nenit 90 par.4 të tij ku thuhet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 (tri) vjet.”*, siç është dhe me këtë Kontratë (e cila ka qenë në fuqi konform nenit 45 par.2 të saj, deri me datën 22.01.2021), e që kjo çështje është rregulluar njëjtë dhe me dispozitat e nenit 35 par.5 dhe 7 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë në fuqi nga data 22.01.2021 të cilat gjejnë zbatim në rastin e paditësit.

Gjykata lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë vendosi duke u bazuar në Vërtetimin Nr.pr.../3 të datës 08.09.2023, mbi ditët e pranisë në punë të paditësve, lëshuar nga SHFMU “S. F.” në Zh., Podujevë, dhe vërtetimit mbi çmimin e udhëtimit shkuarje-ardhje për relacionin që bënë paditësi të lëshuar nga NTP “D.” në Podujevë, dt.22.09.2023, si dhe bazuar në Informatën e dhënë lidhur me prezencën në punë Nr.05-93 të datës 18.12.2020 e lëshuar nga Komuna e Podujevës, Drejtoria e Arsimit për periudhën nga data 18.04.2017 deri me 31.12.2021, si provë, me ç’rast kemi të bëjmë me një dokument publik i cili ka fuqi të plotë provuese, e që në anën tjetër e paditura nuk i ka rrëzuar me prova materiale fuqinë provuese të këtij dokumenti, e gjithë kjo dhe bazuar në dispozitën e lart cituar të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, konkretisht nenit 35 par.5 dhe 7 të saj.

Gjykata i konsideron si të papranueshme dhe të pabazuara pretendimet dhe kundërshtimet e paditurës se ajo nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit me arsyetim se nuk ka buxhet për të bërë këto pagesa në emër të kompensimit për kërkesat e paditësit, për çka edhe i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Ju refuzua si e pa bazuar kërkesa e paditësit në emër të kompensimit të ushqimit-shujtave ditore përtej shumës së aprovuar, si e pabazuar, për ditët e pranisë në punë për periudhën nga data 18.04.2017 deri 31.12.2021, dhe atë për 444 ditë të pranisë në punë, ngase gjykata gjatë shqyrtimit të padisë, pretendimeve të dhëna në përgjigje në padi dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta, gjeti se paditësit i është aprovuar kërkesa sa i përket Ushqimit-shujtave ditore për ditët e pranisë në punë për periudhën e cituar, kjo sipas Aktgjykimit C.nr.114/2020 i datës 18.05.2022, e i cili Aktgjykim tanimë ka marrë formën e prerë me datën 31.05.2022. Andaj, paditësit ju refuzua kërkesa për kompensimin e shujtës ditore për periudhën e cekur më lartë si e pa bazuar, për shkak se çështja e ngritur me padi tani përbënë çështje të gjykuar (res judicata) dhe si e tillë kjo çështje juridike, tani është jolëndore, kjo konform nenit 166.2 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), me të cilin është paraparë se: *“Gjykata gjatë gjithë procedimit të çështjes kujdeset sipas detyrës zyrtare se a mos është e gjykuar çështja e ngritur me padi dhe nëse konstaton se procedura e iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme”*.

Ndërsa, ju refuzua kërkesa e paditësit përtej shumës së aprovuar në shumën si në dispozitiv të aktgjykimit, si e pa bazuar, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për 70% të biletës, për ditët e pranisë në punë dhe atë për periudhën kohore 18.04.2017 deri me datën 10.01.2019, për 370 ditë të pranisë në punë, meqë gjykata në kuptim të rrethanave të konstatuara me lart dhe duke e vlerësuar prapësimin e të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjeti se kërkesa për këtë periudhë është e parashkruar. Kjo konform dispozitës së nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, (e cila dispozitë ka karakterin prekluziv) ku lidhur me kërkesat në para nga marrëdhënia e punës është paraparë afati i parashkrimit ashtu që është përcaktuar se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”*, i cili afat në rastin konkret ka kaluar para se të jetë ngritur padia dhe atë nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive dt.18.04.2017 deri në ngritjen e padisë 10.01.2022, kanë kaluar mbi 3 vite me çka është parashkruar dhe kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për 70% të biletës për ditët e pranisë në punë, për këtë periudhë konform dispozitave të lart cituara.

Kamatëvonesa është vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 382 të Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e palëve dhe provat tjera të ofruara, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes kontestimore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449, 450, 452 dhe 453.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore si dhe Rregullores për Tarifat e Avokatëve e Odës së Avokatëve të Kosovës (2017). Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet për përpilimin e padisë shuma prej 104 eurove, si dhe taksave gjyqësore të paguara për padi në shumë prej 20 eurove, duke marrë për bazë vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë dhe suksesit në procedurë.

Gjykata ka refuzuar shpenzimet tjera të kërkuara, ngase kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohej kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë e posaçërisht jo lidhur me parashtrësën e dorëzuar sipas aktvendimit për plotësimin e padisë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Vendimi lidhur me detyrimin e paditësit për pagesën e taksës shtesë për padinë e ushtruar në gjykatë, u mor konform dispozitave të nenit 253.1 dhe 4 të LPK-së, si dhe nenit 12.1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, duke detyruar paditëset që në emër të taksës gjyqësore shtesë për padi të paguajë shumën prej 10.00 €, në bazë të vlerës së kërkesëpadisë të saktësuar me parashtrësën e datës 31.10.2023, meqë gjykata nuk ka dëshmi se është paguar nga paditësi, ngase me rastin e dorëzimit të padisë në gjykatë është paguar vetëm taksa gjyqësore në shumën prej 20.00 €.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

**Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.31/2022, me datën 12.01.2024**

Gjyqtari:
Nazmi Neziri

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.